



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:127907

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870833

KPPP.nr.2514/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit “Phoenix Pharma” SH.P.K., me numër të biznesit: 70946335, me seli në rr. “Aziz Abrashi” Zona Industriale, në Prishtinë, kundër debitorit N.T.SH. “Diellza”, me pronar P.N., me seli në rr. “Vëllezërit Gashi”, në Gjakovë, me NUI: 80456034, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.04/20 të datës 08.01.2020, të Përbaruesit Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 27.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.T.SH. “Diellza”, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.04/20 i datës 08.01.2020, i Përbaruesit Privat Valdrin Beka.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përbarimor P.nr.04/20 i datës 08.01.2020 i lejuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka.
- III. URDHËROHET debitori N.T.SH. “Diellza”, që në rast të parashtimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 10,228.14 € (dhjetë mijë e dyqind e njëzet e tetë euro e katërbëdhjetë cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Phoenix Pharma” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.04/20 të datës 08.01.2020, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës No: 19327/19 të datës 13.07.2019; Faturës No: 17352/19 të datës 17.06.2019; Faturës No: 16073/19 të datës 03.06.2019; Faturës No: 8396/19 të datës 18.03.2019; Faturës No: 6818/19 të datës 04.03.2019; Faturës No: 4305/19 të datës 11.02.2019; Faturës No: 4306/19 të datës 11.02.2019; Faturës No: 13993/19 të datës 13.05.2019; Faturës No: 27177/19 të datës 14.10.2019; Faturës No: 27176/19 të datës 14.10.2019; Faturës No: 27175/19 të datës 14.10.2019; Faturës No: 27172/19 të datës 14.10.2019; Faturës No: 27174/19 të datës 14.10.2019; Faturës No: 15559/19 të datës 29.05.2019; Faturës No: 15561/19 të datës 29.05.2019; Faturës No: 10524/19 të datës 08.04.2019; Faturës No: 10527/19 të datës 08.04.2019; Faturës No: 10541/19 të datës 08.04.2019; Faturës No: 9607/19 të datës 29.03.2019; Faturës No: 9086/19 të datës 25.03.2019; Faturës No: 4885/19 të datës 15.02.2019; Faturës No: 3769/19 të datës 06.02.2019; Faturës No: 4975/19 të datës 16.02.2019; Faturës No: 4889/19 të datës 15.02.2019; Faturës No: 4888/19 të datës 15.02.2019; Faturës No: 4975/19 të datës 16.02.2019; Faturës No: 4887/19 të datës 15.02.2019 dhe Faturës No: 4886/19 të datës 15.02.2019; me të cilën është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekura, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 10,228.14€, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të përmbaruesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbarimore të zbatoj përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, ku ndër të tjerash ka deklaruar se me kreditorin kanë pasur marrëdhënie afariste dhe çdo herë në fillim të vitit është bërë barazimi i librave afarist për vitin paraprak, por që në rastin konkret nuk është bërë barazimi i librave afariste. Ka shtuar se në bazë të kartelës financiare të debitorit për periudhën 06.02.2019 e deri me datën 18.11.2019 ndaj kreditorit kanë obligim për shumën prej 1,905.14 €, prandaj nuk janë në këtë çështje nuk janë plotësuar kushtet

për parashtrimin e propozimit për përmbarrim. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, si dhe të abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit. Sa i përket pretendimit të debitorit se në mes të palëve është bërë barazimi i kartelave financiare cdo vit dhe pastaj janë dakorduar për mënyrën e kthimit të borxhit, ka theksuar që e njëjta nuk paraqet bazë për mospagesë të faturave nga ana e debitorit, duke shtuar që çdo faturë ka të përcaktuar afatin 30 ditor të pagesës dhe se nuk është e domosdoshme të pritët fundi i vitit për barazim të kartelave. Ndërsa në lidhje me pretendimin e debitorit se borxhi aktual i tij është në shumën prej 1,905.30 €, ka theksuar që një gjë e tillë nuk është provuar me asnjë dëshmi nga pagesat e bëra ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri për përmbarrim, si dhe të detyrohet debitori që të përmbush obligimin sipas këtij urdhri.

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbarrimore me Aktvendimin PPP.nr.22/20 të datës 02.03.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.755/22 të datës 21.11.2022, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit dhe ka prishur aktvendimin PPP.nr.22/20 të datës 02.03.2021, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm dhe lëndën ia ka kthyer Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha

elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbardim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën No: 19327/19 të datës 13.07.2019; Faturën No: 17352/19 të datës 17.06.2019; Faturën No: 16073/19 të datës 03.06.2019; Faturën No: 8396/19 të datës 18.03.2019; Faturën No: 6818/19 të datës 04.03.2019; Faturën No: 4305/19 të datës 11.02.2019; Faturën No: 4306/19 të datës 11.02.2019; Faturën No: 13993/19 të datës 13.05.2019; Faturën No: 27177/19 të datës 14.10.2019; Faturën No: 27176/19 të datës 14.10.2019; Faturën No: 27175/19 të datës 14.10.2019; Faturën No: 27172/19 të datës 14.10.2019; Faturën No: 27174/19 të datës 14.10.2019; Faturën No: 15559/19 të datës 29.05.2019; Faturën No: 15561/19 të datës 29.05.2019; Faturën No: 10524/19 të datës 08.04.2019; Faturën No: 10527/19 të datës 08.04.2019; Faturën No: 10541/19 të datës 08.04.2019; Faturën No: 9607/19 të datës 29.03.2019; Faturën No: 9086/19 të datës 25.03.2019; Faturën No: 4885/19 të datës 15.02.2019; Faturën No: 3769/19 të datës 06.02.2019; Faturën No: 4975/19 të datës 16.02.2019; Faturën No: 4889/19 të datës 15.02.2019; Faturën No: 4888/19 të datës 15.02.2019; Faturën No: 4975/19 të datës 16.02.2019; Faturën No: 4887/19 të datës 15.02.2019 dhe Faturën No: 4886/19 të datës 15.02.2019; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në original, si dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit nga debitori, ndërsa Fatura Nr. 4975/19 të datës 16.02.2019 edhe pse nuk përmban nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit, rezulton se e njëjta është pranuar nga debitori, si dhe nuk është kontestuar në asnjë formë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2514/22, datë 27.06.2024.

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.